

VENDIM
Nr. 68, datë 11.5.2017

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1 germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k. , në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b” të plotësuara ; germat “c” dhe “d” të paplotësuara.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është i paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërinë Albanian Green Energy sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti